



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

NGA: Sami Hamiti, Kryeshef i Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës

PËR: Ismet Beqirin, Kryetar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: Propozim për ndryshim dhe plotësim të rregulloreve komunale

DATA: 30.06.2003

Në pajtim me dispozitat e nenit 52 shkronja (a) e Statutit të Komunës së Prishtinës të datës 16.03.2001, Vendimit të Bordit të Drejtorëve të miratuar me 19.06.2003, Komitetit për Politikë dhe Financa për shqyrtim dhe Kuvendit të Komunës së Prishtinës për miratim, i **propozohet** që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e:

RREGULLORËS KOMUNALE PËR RENDIN KOMUNAL. **01. nr. 110-2914 e datës 12.12.2001.**

MBIKËQYRJA

NENI 10, Ndryshohet dhe thotë:

Zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje e bënë organi i administratës komunale kompetente për shërbime publike, ndërsa mbikëqyrjen inspeksionale e bënë Sektori i Inspektionit Komunal të Drejtoratit për Inspektion dhe Policia.

GJOBAT

NENI 11, Ndryshohet dhe thotë:

11.1 Më gjobë prej 250 deri 600 Euro, do të gjobitet për kundërvajtje: ndërmarrja private, ndërmarrja komunale dhe ajo shoqërore, institucionet e administrimit të përkohëshëm, entet, shkollat, institucionet tjera si dhe personat tjerë juridik, nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.

11.2 Më gjobë prej 150 deri 250 Euro do të gjobitet për kundërvajtje qytetari, pronari i dyqanit hotelier, tregëtar dhe zejtar, nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.

11.3 Me gjobë prej 100 Euro e cila arkëtohet në vendin e ngjarjes (gjoba mandatore) do të gjobitet për kundërvajtje qytetari dhe pronari i dyqanit nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

NENI 12, Ndryshohet dhe thotë:

12.1 Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesen Drejtorati për Shërbime Publike, Transport e Ambient, Drejtorati i Inspektionit dhe **Policia.**